



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 92/5 Prot.

Tiranë, më 14/04/2021

V E N D I M

Nr. 29, datë 14.04.2021

“PËR

MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË” NË INXHINIERI NDËRTIMI, PROFILI INXHINIERI MJEDISI, PRANË DEPARTAMENTIT TË INXHINIERISË SË MJEDISIT, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT”.

Mbështetur në Ligjin Nr.80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr.41, datë 24.1.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr.879, datë 18.12.2019 për "Disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.41, datë 24.1.2018", Udhëzimit të MASR Nr. 1, datë 14.01.2020, për "Dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njësave kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë, kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 14.04.2021,

V E N D O S I:

Miratimin e propozimit për riorganizimin e programit të ciklit të tretë të studimit "Doktoratë" në Inxhinieri Ndërtimi, Profili Inxhinieri Mjedisi, pranë Departamentit të Inxhinierisë së Mjedisit, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al